



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.07.2019, ora 9.00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Diskutimi në parim i projektligjit “Për Rininë”, propozim i Këshillit të Ministrave (*komision përgjegjës*).

2. Miratimi i vendimit nr. 11 të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, për shpalljen e një vendi vakant pranë Autoritetit të Medieve Audiovizive, pas lirimit nga detyra të anëtarit të AMA-s, zotit Zylyftar Bregu, me vendimin e Kuvendit nr. 82/2019, mbështetur në pikën 2, të nenit 9, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Kostaq Papa dhe Selami Jenishehri.

Mungojnë:

Enada Kapllani, Klajdi Qama.

Të ftuar:

Besa Shahini – Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

Zamira Gjini – drejtoreshë e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

Erzen Tola – drejtor i Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

Matilda Bulku – specialiste e Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Kërkimit Shkencor në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

Eridon Kotri – këshilltar për Mediet në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

HAPET MBLEDHJA

Fatjona Dhimitri – Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Sot në rendin e ditës kemi diskutimin në parim të projektligjit “Për rininë”, propozim i Këshillit të Ministrave.

Të ftuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë kemi: zonjën Besa Shahini, ministre; zonjën Zamira Gjini, drejtoreshë e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë; zotin Erzen Tola, drejtor i Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator; zonjën Matilda Bulku, specialiste e Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Kërkimit Shkencor në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe zotin Eridon Kotri, këshilltar për mediet.

Fillojmë me prezantimin e projektligjit.

Urdhëroni, zonja Ministre!

Besa Shahini – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Shumë faleminderit për ftesën për të prezantuar sot projektligjin “Për rininë”, një punë disamujore ose gati dyvjeçare, që ka rezultuar në draftligjin që keni përpara!

Projektligji mbron dhe zhvillon interesat e të rinjve, pra synon të respektohen të drejtat e të rinjve; garanton pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje, si një gjë që e synojnë jo vetëm të rinjtë, por të gjithë qytetarët e Republikës; garanton organizimin politik të të rinjve për të mbrojtur të drejtat e tyre; garanton mosdiskriminimin në të gjitha aktivitetet që parashikohen për të rinjtë. Pra, është një ligj që adreson të gjitha aspektet e organizimit të të rinjve, aktivitetet dhe mekanizmat e ndryshëm institucionalë, që nuk kanë qenë të rregulluar nga ligjet e tjera.

Të rinjtë sot kanë një dilemë shumë të madhe, para së cilës jemi gjendur edhe në dhjetor, kur u ballafaquam me protestën e studentëve. E ardhmja është e paqartë, ndryshe nga dekadat e kaluara. Të rinjtë sot nuk e dinë se ku do të punojnë pas dhjetë vjetësh, cilat janë vendet e punës pas njëzet vjetëve, nëse do të jetojnë këtu, do të jetojnë jashtë apo se çfarë duan të bëjnë. Kjo nuk është unike për Shqipërinë, por është një gjeneratë, e cila nuk e ka të ardhmen të përcaktuar, siç ndoshta e kanë pasur prindërit tanë apo një gjeneratë më e madhe se ne.

Ndaj, si Ministri e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, gjithsesi, ajo çfarë duhet të përpiqemi të bëjmë dhe jo vetëm ne, por edhe institucionet e tjera që merren me fëmijët dhe të rinjtë, është të ndërtojmë aftësitë bazike që të rinjtë duhet t’i kenë, në mënyrë që të jenë të suksesshëm [për çfarëdo që do të bëjnë në të ardhmen e tyre.

Të kenë aftësi bazike për tregun e punë, si, për shembull: gjuhët e huaja (gjuhë e parë, e dytë), matematikën, shkencën, aftësitë digjitale. Ato i marrin nga sistemi arsimor, nga shkollat, nga universitetet. Ky është një aspekt i zhvillimit të të rinjve, që përfitohet me rregullimin e arsimit në Shqipëri. Por ka edhe aftësi të tjera që do t'u duhen të rinjve për jetën: të jenë qytetarë të mirë, të kenë mundësi jo vetëm të ushtrojnë të drejtat e tyre, por edhe të kenë përgjegjësi. Një pjesë nga këto aftësitë e tjera merren edhe nga edukimi joformal, i cili nuk është i rregulluar nga ndonjë ligj tjetër dhe është i përcaktuar këtu si një nga aktivitetet që të rinjtë mund ta organizojnë, mund ta ushtrojnë, por edhe mund ta përfitojnë nga kjo.

Në edukimin joformal, për ta konkretizuar disi, përfshihen të gjitha trajnimet e mundshme që mund t'i marrin të rinjtë që i ndihmojnë ose për të ushtruar ndonjë aktivitet, ose për t'u integruar në tregun e punës, ose thjesht për të ushtruar dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre: trajnime të ndryshme të lidershit, të të folurit në publik; trajnime të ndryshme për të përmirësuar çfarëdo formimi profesional që e kanë për fusha të ndryshme, të cilat kanë nevojë për përmirësim të vazhdueshëm. Të gjitha këto konsiderohen si edukim joformal dhe njihen si një aktivitet nga i cili përfiton i riu ose e reja dhe rregullohen me këtë ligj.

Dy risi, që vijnë nëpërmjet këtij ligji janë, në fakt, këshillat kombëtarë dhe këshillat vendorë të rinisë. Këta dy organizma mundësojnë konkretizimin e organizimit politik të të rinjve për të mbrojtur të drejtat e tyre dhe për të çuar përpara më të mirat që ata dëshirojnë, pra interesi për të çuar përpara interesat e tyre.

Këshilli Kombëtar Rinor dhe Këshilli Rinor Vendor përcaktohen njëri me vendim të Këshillit të Ministrave, për të cilin duhet të ndërtohet edhe një bazë ligjore e mëtejshme për të përcaktuar mënyrën se si funksionon në nivel kombëtar, ndërsa Këshilli Vendor i rinisë, për sa u përket detajeve se si do të funksionojë pjesëmarrja e të rinjve. Mënyra se si ata pastaj marrin pjesë në politikëbërje dhe në vendimmarrje përcaktohet me vendim të këshillave bashkiakë. Këto dy organizata do të mundësojnë që në nivel më të madh të përfshijnë të rinjtë në vendimmarrje. Ata e dinë shumë më mirë se të gjithë të tjerët se cilat janë nevojat, kërkesat e tyre dhe për çdo nismë ligjore, për çdo aktivitetet tjetër, që ndërmerret nga qeveria, qoftë në nivel kombëtar, qoftë në nivel vendor, do të konsultohen në mënyrë që të marrin edhe mendimet e të rinjve, por edhe këta të fundit të përfshihen në të gjitha këto nisma ligjore ose në politika të tjera, që i përkasin ose prekin të rinjtë, por edhe që ndoshta nuk i prekin në mënyrë direkte, po do t'i prekin në mënyrë indirekte në të ardhmen.

Jashtë ligjit vlen të përmendim se ne po punojmë shumë fort që të ndërtojmë edhe parlamentin e nxënësve, pra flasim për një grupmoshë më të vogël, që nuk përcaktohet me ligji

i rinisë si “të rinj”. Kjo është e rëndësishme për ne si Ministri e Arsimit, Sportit dhe Rinisë që të gjithë ata që aktivizohen në shkollat e tyre, mbrojnë të drejtat e fëmijëve dhe çojnë përpara kërkesat e tyre për nisma të ndryshme që Ministria e Arsimit duhet t’i marrë parasysh në bashkëpunim me shkollat, në mënyrë që edhe zërat e tyre të dëgjohen. Kjo nuk është e rregulluar me këtë ligj, por desha thjesht ta përmend si një nismë e filluar në maj të vitit 2019, por që do të konkretizohet në vjeshtë, kur kemi edhe zgjedhjet e para për parlamentin e nxënësve në rang kombëtar.

Ligji, gjithashtu, përcakton se cilat janë organizatat rinore dhe cilat janë organizatat që merren me çështjet e të rinjve. Organizatat rinore janë të gjitha grupimet, që përmbajnë në vetvete anëtarësi, diku rreth 70% të të rinjve. E kemi lënë me 70%, për shkak se ndonjëherë është e vështirë për organizatat që të mbajnë 100% anëtarësi të të rinjve, pasi ndonjëri mund të fillojë të merret me një aktivitet rinor në moshën 25-vjeçare dhe, kur të arrijë në moshën 30-vjeçare, mund të jetë në një pozitë udhëheqëse dhe nuk do të duhet të largohet nga organizata menjëherë. Kështu që, përdërisa e plotësojnë kriterin e pjesëmarrjes 70% të të rinjve, organizata mund të quhet rinore. Ndërsa organizatat, që merren me aktivitetet për të rinjtë, janë ato organizata që duhet të plotësojnë një kriter të rëndësishëm: së paku në tre vjetët e fundit të jenë marrë me projekte ose të kenë kryer aktivitete që u përkasin të rinjve, ose prej të cilave përfitojnë specifikisht të rinjtë.

Këto dy përkufizime përfshijnë në vetvete edhe regjistrimin, pra kërkohet edhe regjistrimi i këtyre organizatave si organizata të shoqërisë civile, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Përcaktimet e tjera se si duhet të regjistrohet një organizatë, mënyra se si ata e marrin statusin e organizatës joqeveritare e përcakton një ligj tjetër.

Ligji “Për rininë” thjesht i ka përkufizuar këto dy kategori, si dy kategori, të cilat pastaj në të ardhmen mund të marrin edhe përfitime financiare nga buxheti i shtetit, nëse arrijnë të përcaktojnë projekte vërtet me një benefit për të rinjtë.

Projektligji përcakton, gjithashtu, edhe organizatën kombëtare përfaqësuese të rinisë. Nëse organizatat rinore ose organizatat për të rinjtë dëshirojnë të federalizohen që të bëhen bashkë dhe, duke i bërë të gjitha forcat bashkë, të çojnë përpara në mënyrë më serioze punën që bëjnë për interesat e të rinjve, atëherë kjo tashmë mundësohet. Organizata kombëtare përfaqësuese e rinisë duhet të ketë së paku 30 organizata në përbërjen e saj; anëtarësia duhet të ketë së paku 70% të rinj dhe duhet të ketë së paku 1000 anëtarë. Këto janë modele të ndryshme që kemi parë në rajon. Këtë organizatë nuk kemi dashur ta shpikim si propozim, por kemi marrë parasysh propozimet që ekzistojnë, në mënyrë që t’u japim mundësinë këtyre organizatave, që

dëshirojnë të organizohen përtej organizatës joqeveritare që kanë dhe të federalizohen në njëfarë mënyre.

Projektligji jep, gjithashtu, përkufizimin për herë të parë të punonjësit rinor, i cili është dikush që është i trajnuar të merret me të rinjtë, të merret me çështje të ndryshme për konsultime, këshillime të ndryshme për tregun e punës, nëse të rinjtë kanë nevojë; konsultime të ndryshme për edukimin e tyre të mëtejshëm apo edhe konsultime, që adresojnë probleme të ndryshme me të cilat të rinjtë merren, si, për shembull, bulizmi online, që është një nga temat që ngrihet vazhdimisht, sa herë kemi takime ose me fëmijë, ose me të rinj.

Punonjësi rinor është dikush që do të mund të jepte më shumë informacion për mënyrën se si qaset një fëmijë ose një i ri në internet të sigurt, për mënyrën si mund ta përdorë rrjetin social, pa u ekspozuar ndaj rreziqeve që ekzistojnë. Por ky është vetëm një shembull konkretizues, sepse punonjësi rinor mund të kryejë edhe aktivitete të tjera. Është e rëndësishme për ne që ta kemi mundësinë ta përkufizojmë këtu dhe pastaj mënyrat se si punonjësi rinor trajnohet dhe se si trajtohet më tutje edhe në edukim, edhe në punësim, do të rregullohen me akte të tjera nënligjore.

Projektligji, gjithashtu, promovon vullnetarizmin. Pra, është punonjësi rinor, që promovon të gjithë të rinjtë duke u sugjeruar të aktivizohen, të organizohen nëpër organizata rinore, nëpër rrjete rinore dhe, në njëfarë mënyre, promovon vullnetarizmin, që është një virtut shumë i mirë, si dhe siguron që të rinjtë do të bëhen qytetarë të mirë dhe të mirërritur, të cilët përkujdesen për rrethin, për shoqërinë dhe duan të kontribuojnë.

Projektligji përcakton hapësirat rinore, si një vend i sigurt, ku të rinjtë mund të mbledhen. Aty ka disa standarde që duhet të plotësohen, të cilat përcaktohen me ligje të tjera: infrastruktura rinore dhe një hapësirë e sigurt rinore. Për ne ishte e rëndësishme që ta përcaktonim edhe këtu, si një hapësirë e cila, pastaj, në të ardhmen mund të përcaktohet, kur organizata të ndryshme rinore do të aplikojnë për grante.

Mund të themi se e kemi projektin për hapësirën rinore, një vend të sigurt, ku ne duam të mbledhemi, të bëjmë organizimet tona, aktivitetet tona, pasi ky është një vend që na e mundëson këtë gjë.

Në thelb, nëse do ta përcaktoja me një fjali qëllimin e këtij projektligji, ai mundëson, në njëfarë mënyre, marrëdhënie më të mira ndërmjet organizatave rinore, të rinjve që kanë vendosur të organizohen dhe institucioneve të ndryshme shtetërore. Pra, ne na mundëson financimin e organizatave rinore, duke përcaktuar aktivitetet që organizatat rinore mund të ndërmarrin, duke përcaktuar cila është një organizatë rinore, cilat janë hapësirat ku ata mund

të ekzistojnë, të punojnë dhe të kryejnë aktivitetet e tyre. Pra, për herë të parë, nëpërmjet këtij projektligji bëhet e mundur që organizatat rinore ose organizatat për të rinjtë, si dhe të gjitha organizatat që merren me promovimin e të rinjve të kenë mundësi të financohen edhe nga buxheti i shtetit. Për ne është e rëndësishme që ta kemi këtë bazë ligjore dhe t'i ndërtojmë këto marrëdhënie me të rinjtë.

Protesta e dhjetorit nxori në pah disa çështje. Ndër to ishte edhe cilësia e arsimit të lartë. Me “Paktin për universitetin” po përpiqemi maksimalisht që të merremi me të gjithë aspektin e eksperiencës studentore, me aspektin e cilësisë së arsimit që studentët marrin në nivelin e arsimit të lartë në Shqipëri. Pjesa e jetës rinore, organizimit dhe e vullnetarizmit rregullohet me ligjin “Për rininë”.

Ne e pamë të arsyeshme që ta çojmë përpara në këtë moment ligjin “Për rininë”, pasi na mundëson që me të rinjtë dhe për të rinjtë të bashkëpunojmë edhe në aspekte të tjera të rëndësishme për zhvillimin e tyre të përgjithshëm.

Fatjona Dhimitri – Fjalën e ka relatorja e caktuar për projektligjin, nëse ka diçka për të shtuar.

Almira Xhembulla – Së pari, shumë faleminderit, zonja Ministre, për këtë projektligj, i cili pa dyshim ka një target jo thjesht vulnerabël, por atë më domethënës, më cilësor dhe më vital për sa i përket investimit që duhet të bëjë shteti shqiptar! Madje, jemi të gjithë shumë të kënaqur, siç e thatë edhe ju, që pas një përpjekjeje gati dyvjeçare dhe shtysës jo vetëm të qeverisë shqiptare, por edhe të organizatave që merren me çështjet rinore për të pasur një ligj, i cili do të shërbejë si një rregullator për sa u përket çështjeve që lidhen me rininë.

Ju ishit shumë shteruese për sa u takon të gjitha risive që sjell projektligji. Ashtu siç ju i përmendet mekanizmat që do të përdorë ky projektligj për fuqizimin e të rinjve, koncepti i edukimit joformal, ngritja e këshillit kombëtar të rinisë dhe këshillit vendor të rinisë, institucioni përgjegjës, i cili do të harmonizojë dhe do të koordinojë punën e të gjitha organizatave dhe strukturave të qeverisjes lokale, sa i takon punës që bëhet me rininë, pa dyshim që do të shërbejë për të rritur impaktin e të gjitha shërbimeve dhe të gjitha përpjekjeve që bëhen për të shtuar interesin e të rinjve për të jetuar, për të investuar dhe për të menduar seriozisht për të ardhmen e tyre në Shqipëri, sepse, ashtu siç ju e përmendet, ka një apati tek të rinjtë sa i takon të ardhmes së tyre. Besoj që edhe në shqyrtimin nen për nen do të diskutojmë për çështje konkrete, por dua të bëj një pyetje sa i takon infrastrukturës përgjegjëse lidhur me implementimin e këtij ligji.

Fajtona Dhimitri - Zonja relatore, pyetjet dhe diskutimet do t'i diskutojmë më vonë. Vazhdojmë me relatimin e çështjes.

Almira Xhembulla- Duke qenë se ka të bëjë me një sërë mekanizmesh që ju prezantuat dhe besoj që...

Faleminderit kryetare, që ma kujtove, por, ashtu siç e thashë që në fillim, informacioni që përcolli ministrja përfshinte të gjitha ato që unë kisha parashtruar si risi, kështu që nuk dua të zgjatem dhe të ndalem në përsëritje. Meqenëse kryetarja tha që pyetjet do t'i lëmë më vonë, unë dua të falënderoj ministrinë për mënyrën se si ka bashkëpunuar me organizatat dhe për punën e jashtëzakonshme që është bërë për këtë projektligj. Pa diskutim do të kemi mundësinë të përfshijmë disa nga komentet e tyre dhe të jemi në koordinim me ministrinë dhe me të gjitha grupet e interesit për të pasqyruar dhe për ta finalizuar, në mënyrë që të jemi sa më përfshirës dhe të kemi një variant sa më të mirë të mundshëm në fund.

Faleminderit!

Fajtona Dhimitri- Faleminderit!

Atëherë, unë propozoj që prezantimin e projektligjit ta ndajmë në dy faza. Fillimisht të bëjmë pyetjet drejtuar të ftuarve dhe pastaj vazhdojmë me diskutimin në parim të projektligjit. A jeni dakord?

Vazhdojmë me pyetjet.

Zonja Ministre, kuptohet që projektligj për rininë që në draftimin e tij është i vakët. Ai fillon me qëllimin, pa parashtruar objektin dhe fushën e veprimtarisë së këtij projektligji. Pse projektligji për rininë nuk ka një objekt? Çfarë përfshin ky projektligj?

Së dyti, në nenin 1 titulli është: "Të rinjtë shqiptarë në diasporë". Cilat janë përfitimet e të rinjve në diasporë sipas këtij projektligji? Cilat janë organet dhe institucionet përkatëse që do të merren me këtë pjesë, kooperimi i këtyre organeve dhe institucioneve? Cila është mënyra e organizimit të tyre në lidhje me të rinjtë në diasporë?

Së treti, sipas Këshillit të Ministrave, cili është ndryshimi midis organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë?

Në nenin 5 përcaktohet se ministria përgjegjëse për rininë harton dhe propozon politika dhe veprimtari për rininë dhe planifikon buxhetin për financimin e veprimtarive në fushën e rinisë. Si mund të planifikojë ministria përgjegjëse për rininë buxhetin për financimin e veprimtarive në fushën e rinisë pa u konsultuar më parë me organizatat rinore, Këshillin Kombëtar të Rinisë dhe grupet e tjera për rininë?

Çfarë nënkuptojmë me institucione të tjera qendrore sipas projektligjit?

Cili është koordinimi i zbatimit të politikës shtetërore rinore në bashkëpunim me organizatat jofitimprurëse të të rinjve, si dhe me njësitë e qeverisjes vendore?

Cilët janë 14 anëtarët e Këshillit Kombëtar Rinor dhe cili është numri i përfaqësimit të të rinjve në këtë këshill?

A duhet që ministria përgjegjëse për rininë, e cila njeh vetëm një organizatë kombëtare përfaqësuese rinore, të bazohet vetëm në numrin e shtimit të anëtarëve të rinj në çdo kohë?

Cili është kriteri i përfaqësimit të organizatave kombëtare në një organizatë kombëtare përfaqësuese rinore? A përcaktohet vetëm nga numri i këtyre anëtarëve apo edhe nga rezultatet e punës së këtyre organizatave për t'u përfaqësuar në një organizatë kombëtare rinore?

Në projektligjin e sjellë nuk parashikohet karta rinore. Projektligji parashikon disa institucione, të cilat do të merren me zbatimin e tij, por nuk parashikon një strukturë vertikale dhe horizontale të organeve përgjegjëse direkt për zbatimin e ligjit. Cilat do të jenë këto organe?

Zonja Ministre, fjala për ju.

Milva Ekonomi – Unë mendoj se duhet të mbledhim të gjitha pyetjet e komisionit dhe t'ia japim zonjës ministre.

Fatjona Dhimitri- Dakord. Kush ka pyetje?

Po, zonja Ekonomi.

Milva Ekonomi- Në definicionin që keni përdorur për moshën e të rinjve, a jeni bazuar në standardin e Kombeve të Bashkuara?

Fadil Nasufi – Cilit model i jeni referuar për draftligjin? Pa dyshim që këtu përfshihet koncepti dhe organizimi i Këshillit të Europës, por pyes për modelet që ne kemi një lloj qasjeje. A janë bërë konsultat me aktorët institucionalë me ministrinë, sidomos me bashkitë, sepse struktura përcakton që institucioni qendror është Ministria e Arsimit, ndërsa në institucion vendor janë bashkitë?

Buxhetet që parashikohen do të akordohen në bazë të peshës që zënë të rinjtë në përqindjen e popullsisë, apo do të jenë në dëshirë të këshillit bashkiak dhe kryetarit të bashkisë? Sipas përvojës që kam, hap pas hapi ligji i detyronte bashkitë të ngrinin struktura të reja për shërbimet sociale apo për personat me aftësi të kufizuara dhe nuk i bënin, por vetëm bënin qoka. Pra, a do të ketë një buxhet të shëndetshëm, të detyrueshëm dhe të kushtëzuar disi, të mos jetë thjesht një adresim, ku zgjidhja e problemit lihet jetim?

A ka një inventar të problematikave dhe mungesave që ka logjistika dhe infrastruktura për aktivitetet rinore, qendra social-kulturore të trashëguara nga sistemi, terrene sportive e të tjera me radhë, sepse realitetin e ballafaqon me një situatë jo të mirë, sidomos në fshat, ku nuk

janë lënë hapësira për këtë punë? Atje ka mungesa dhe kërkojnë investime kapitale për të plotësuar, të paktën në mënyrë modeste, kushtet e domosdoshme për të ushtruar aktivitete të karakterit sportiv, kulturor, artistik e të tjera me radhë.

A do të vazhdojmë të kemi vetëm projekte me konkurrim për rininë, apo do të kemi një kalendar tradicional të përvitshëm, sipas specifikave që kanë? Konkurrimi është diçka tjetër, prandaj mendoj se duhet të ketë një kalendar që duhet të kenë qytete dhe bashki të veçanta.

Së fundi, sektorit privat sot ka sipërmarrje të mëdha me 1000-2000 punonjës, por ka edhe sektorë të vegjël, që mund të kenë rrjete rinore sipas karakterit profesional të punësimit. A është parashikuar në ligj që sipërmarrjet e mëdha të plotësojnë një logjistikë dhe infrastrukturë të domosdoshme jo vetëm për statusin dhe Kodin e Punës, por edhe për aktivitetet që mund të bëhen?

Faleminderit!

Kostaq Papa- Përshëndetje, zonja Ministre!

Unë dua të bëj dy pyetje.

Meqenëse unë jam përfaqësues politik i emigracionit dhe diasporës, dua t’ju pyes nëse do të ketë përfaqësim të përhershëm të një të riu nga diaspora ose emigracioni në Komitetin e Rinisë?

Nga mënyra se si u shprehët, a nuk ju duket se strukturimi rinor është sipas modelit të vjetër të diktaturës? Meqenëse ju jeni nga Kosova, kam përshtypjen se edhe në kohën e diktaturës serbo-sllavo-komuniste organizimi ka qenë gati i përafërt dhe mënyra se si u shprehët më krijoi një përshtypje të modelimit të vjetër të organizimit të rinisë. A e vini re ju këtë?

Unë nuk jam gjuhëtar, por jam njeri i letrave, prandaj dua t’ju bëj një korrigjim gjuhësor. Gjatë fjalës suaj më kujtuat të folurën e çamërisë sime të fëmijërisë, kur flisnim në shtëpi, prandaj dua t’ju korrigjoj lidhur me përdorimin e fjalës “të rinjtë”, e cila nuk duhet të jetë “të rijtë”, por “të rinjtë”. Kjo ndërhyrje ishte për një komunikim më të mirë midis nesh dhe për një bashkëpunim më të mirë, për të krijuar një ligj sa më të mirë dhe e folura të jetë më e mirë.

Faleminderit!

Adelina Rista – Faleminderit, zonja Ministre, që keni sjellë një projektligj për rininë!

Parashtrimi juaj, për mendimin tim, ishte shterues, megjithatë ne duhet të bëjmë disa pyetje për të qartësuar edhe ndonjë gjë që ka kaluar.

Institucioni përgjegjës për rininë është person publik, juridik dhe buxhetor, që varet nga ministria përgjegjëse, ndërsa pranë bashkive funksionon Këshilli Vendor për Rininë, ku përgjegjës është kryetari i bashkisë, i cili ka të drejtë të zgjedhë 4 vetë. Dua të di nëse do të ketë në bashki një strukturë përgjegjëse për rininë dhe të punojë pikërisht për këtë drejtim, ose ndryshe zyra që përgjigjet për rininë? Për shembull, sot pranë Drejtorisë së Artit dhe të Kulturës apo të marrëdhënieve me publikun ka një person që merret dhe përgjigjet për këtë grup interesi, për të rinjtë. Nesër, në bazë të këtij ligji, a do të ketë një strukturë të posaçme buxhetore, e cila do të përgjigjet për rininë?

Faleminderit!

Almira Xhembulla – A ka Ministria e Arsimit një inventar të saktë të të gjitha aseteve publike, që do t'i vënë në shërbim të implementimit të këtij ligji?

Duke qenë se kemi informacion se disa prej tyre nuk janë në gjendje të mirë, si mendohet rivitalizimi i gjithë këtyre hapësirave publike për t'i vënë në shërbim të rinisë?

Së dyti, a do të ngrihen qendra rinore në të gjitha bashkitë e Shqipërisë, sepse, në dijeninë time, jo të gjitha bashkitë kanë? Ka filluar një pilotim, që është mbështetur nga disa bashki kryesore, por shpresoj dhe nuk e di si parashikohet që të shtrihet në të gjitha bashkitë e vendit?

Ju theksuat një mekanizëm, i cili do të mundësojë që organizatat të marrin fonde nga qeveria shqiptare në lidhje me implementim e disa projekteve. A mund të na jepni pak më shumë informacion si do të funksionojë ky bashkëpunim? Ne e dimë se deri tani raste të tilla nuk kanë funksionuar shumë në Shqipëri, që organizatat të përfitojnë fonde nga qeveria shqiptare, pasi kryesisht ata operojnë me donatorë dhe organizata ndërkombëtare.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Urdhëroni, zonja Ministre!

Besa Shahini – Faleminderit për pyetjet!

Unë do t'ju jap disa përgjigje të përgjithshme, më pas do t'i kërkoj zotit Erzen dhe zonjës Zamira që të japin kontributin e tyre për nene specifike.

Definicioni i moshës nga 15 deri në 29 vjeç, si dhe fryma e ligjit kanë ardhur përmes një bashkëpunimi mes personave në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe UNFPA-së, që është agjenci e Kombeve të Bashkuara. Është marrë definicioni i Kombeve të Bashkuara dhe të gjithë ekspertizën e kemi marrë nga ata, sepse e kemi parë të arsyeshme që të marrim

ekspertizën e një organizate, e cila ka eksperiencën e të gjithë botës, për mënyrën se si organizon politika të ndryshme, në këtë rast politikat rinore.

Projektligji është konsultuar me shumë aktorë. Vjet në korrik është bërë një konferencë kombëtare, është bërë një konferencë ndërkombëtare në vjeshtë, gjithashtu është bërë edhe një tur, ku kolegët e mi, Lorena Haxhiu, zëvendësministria, që më parë ka qenë udhëheqëse e Shërbimit Kombëtar Rinor, ish-zëvendësministri, Shpati Kolgega me të gjithë ekipin që merret me çështjet rinore në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë kanë shkuar në 12 qarqe, kanë vizituar shumicën e bashkive dhe kanë bërë bashkëbisedim direkt me të rinjtë për elemente të ndryshme të projektligjit. Natyrisht, versioni që ju sot keni para, dallon shumë prej versionit fillestar me të cilin kemi filluar, për shkak se kemi dashur të përfshijmë komentet e të gjithë të rinjve me të cilët jemi konsultuar.

Gjithashtu, organizatat e ndryshme joqeveritare kanë qenë pjesë e konsultimeve, na kanë shkruar letra, na kanë dërguar *email-e* apo kanë ardhur nëpër takime tona dhe të gjitha elementet e ndryshme, që kanë qenë të vlefshme për t'u përfshirë në këtë strukturë, që e keni sot para jush, janë të përfshira këtu.

Unë shpresoj që gjatë diskutimeve nëpër komisione, do ta rafinojmë më tutje këtë projektligj, që të kemi një dokument sa më të mirë të mundshëm, që të mund të përfitojnë sa më shumë të rinj.

Dallimi mes organizatave rinore dhe organizatave për të rinj është një: organizatat rinore përbëhen nga vetë të rinjtë, ndërsa organizatat për të rinj mund të përbëhen edhe nga anëtarë, që nuk i përkasin kësaj kategorie, pra nuk janë mes moshës 15-29 vjeçare, por, gjithsesi, merren me aktivitete, projekte nga të cilat përfitojnë të rinjtë. Ky është dallimi kryesor. Arsyeja pse ishte e rëndësishme që t'i përfshijmë këto dy grupe është se të dyja japin një kontribut shumë të madh për zhvillimin e interesave dhe të drejtave të të rinjve.

Grupi i parë mundëson organizimin politik të vetë të rinjve për t'u përfaqësuar, ndërsa grupi i dytë, mund të ketë më shumë ekspertizë dhe ndonjë element më shumë, që mund t'ua sjellë në diskutim të rinjve. Ata mund të përfshihen dhe duhet të përfshihen në këtë marrëdhënie, që po mundohemi ta ndërtojmë me organizatat e ndryshme, për të përfituar të rinjtë.

Për buxhetin, edhe tani që nuk e kemi këtë projektligj, ne gjithmonë kemi marrë parasysh dhe jemi konsultuar me të gjitha organizatat, që mbrojnë të drejtat e të rinjve, por edhe të fëmijëve. Konsultimi ndodh vazhdimisht, edhe para se të kalojë ligji për buxhetin, por edhe kur të bëhet planifikimi afatmesëm buxhetor. Gjithmonë marrim parasysh komentet dhe

sugjerimet e ndryshme të këtyre organizatave dhe, natyrisht, kjo do të vijojë. Tani që i kemi edhe strukturat, ku është Këshilli Kombëtar i Rinisë, Këshilli Vendor i Rinisë, si dhe organizata përfaqësuese e rinisë, të gjitha këto struktura do të jenë të konsultuara para se të merren vendime për buxhetin. Në fund të ditës vendimet për buxhetin merren në mënyrë që këto organizata ta ushtrojnë aktivitetin e tyre në mënyrën sa më të mirë të mundshme. Se kush do të jetë anëtar i Këshillit Kombëtar të Rinisë dhe mënyra se si do të përzgjidhen ata, përcaktohen me një vendim të Këshillit të Ministrave. E kemi lënë këtë mundësi për dy arsye: që të vijojmë konsultimet me organizatat e ndryshme, si dhe me grupe të ndryshme rinore për mënyrën më të mirë të përzgjedhjes dhe përfaqësimit të tyre te ky këshill; së dyti, që të kemi mundësi që në të ardhmen të bëjmë edhe ndryshime, nëse ka nevojë, në një mënyrë më të lehtë se sa ndryshimet në një ligj. Pra, deshëm ta lëmë pak fleksibël, që, nëse në të ardhme mund të kemi grupe të ndryshme rinore, që fillimisht nuk janë paramenduar, por dalin në 2, 3 vjetët e ardhshëm, edhe ato të kenë mundësi të përfshihen me një ndryshim VKM-je. Pra, ky element, ky nen, do të specifikohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Infrastruktura rinore, ashtu si gjithçka tjetër për shkak të decentralizimit, shkollat, por edhe infrastruktura fizike, që i shërben rinisë, është një kompetencë bashkiake. Shpresoj, që përmes këtij ligji, ne do të kemi mundësi të bashkëpunojmë më shumë me bashkitë, në mënyrë që të sigurojmë kushte sa më të mira infrastrukturore për të rinjtë, ku ata mund të ushtrojnë aktivitetet e tyre. Pra, infrastruktura rinore është kompetencë direkte e bashkive. Ndërsa me mënyrën se si ne do të vendosim për financimin e aktiviteteve, se si do të vendosë Ministria e Financave dhe Ekonomisë për financimin e bashkive për mirëmbajtjen e këtyre objekteve, ne do të kemi mundësinë që të ofrojmë më të mirën e mundshme për të rinjtë.

Karta Rinore. Në kuadër të “Paktit për universitetin”, ne kemi vendosur një marrëdhënie shumë të mirë me bashkitë, që të ofrojmë Kartën Studentore, ngaqë ka qenë një obligim i universiteteve, të cilat nuk arritën ta realizojnë për shumë e shumë vite, kështu që vendosëm ta realizojmë bashkërisht me bashkitë si organizata, të cilat janë më të suksesshme në ofrimin e shërbimeve të tilla.

Kartën Rinore kemi vendosur që mos e vendosim si përcaktim ligjor, të mos jemi të ngurtë, por të gjitha organizatat rinore, të gjitha strukturat e ndryshme, nëse kanë interesim dhe nëse të rinjtë kanë interes, do të kenë mundësi ta bëjnë ofrimin e kartës.

Ligji mundëson financimin nga buxheti i shtetit të aktiviteteve të ndryshme rinore, të shërbimeve të ndryshme për të rinjtë, kështu që, nëse organizatat e ndryshme kanë interes dhe kanë mundësi të gjejnë mënyrën, formën më të mirë për të ofruar kartën për të rinjtë, ashtu siç

e ofrojmë ne Kartën Studentore, ta ofrojnë edhe për grupmoshën që nuk është në universitet, atëherë ne jemi plotësisht të gatshëm, në kudër të projekteve, që do të financohen në të ardhmen për të rinjtë.

Do ta mbyll këtu pjesën time, por besoj se çështjet që kishin të bënin me teknikat ligjore, por edhe çështje të tjera përmbajtjesore për ligjin, për nenet e tjera, mund t'i adresojë te kolegët e mi, prandaj i ftoj që të japin kontributin e tyre.

Erzen Tola - Faleminderit, zonja Ministre!

Faleminderit, zonja kryetare!

Në lidhje me pyetjet e tjera për sa i përket objektit të ligjit dhe fushës së veprimtarisë, ky ligj është konsultuar edhe me ekspertët më të mirë të Ministrisë së Drejtësisë, të SIGMA-ës dhe është e dokumentuar, besoj në dosjet tuaj. Nga Këshilli i Ministrave kanë ardhur të gjitha komentet që ka dhënë Ministria e Drejtësisë me shkrim, ku janë reflektuar të gjitha sugjerimet e tyre.

Drafti paraprak ka pasur objekt dhe fushë veprimtarie, të cilat janë integruar në një nen të vetëm, te qëllimi i ligjit. Ky është sugjerimi i ekspertëve dhe kështu është vijuar me projektligjin, gjë e cila është dokumentuar.

Në lidhje me përcaktimet për diasporën, ligji është konsultuar me Ministrinë e Shtetit për Diasporën, përcaktimi për diasporën është futur vetëm në një nen, pasi të gjitha elementet e tjera lidhur me veprimtarinë e të rinjve në diasporë janë parashikuar te ligji për diasporën. Është koordinuar e gjitha si veprimtari se si do të funksionojë dhe si do të integrohen të gjithë të rinjtë e diasporës, në bazë të ligjit për diasporën dhe në bazë të këtij ligji. Mund t'ju them se ky është një nga ligjet e para, që parashikon drejtpërdrejt të rinjtë e diasporës.

Fajtona Dhimitri - Shërbimet konkrete në lidhje me diasporën?

Erzen Tola – Të gjitha shërbimet, që do t'i përfitojnë shtetasit dhe të rinjtë shqiptarë, do t'i përfitojnë edhe të rinjtë shqiptarë në diasporë; janë të unifikuar dhe janë të barazuara.

Në lidhje me organet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji, janë 3 kolona strukturash në ligj, kolona e parë është institucioni përgjegjës që do të jetë në varësi të ministrisë përgjegjëse për rininë dhe ministria përgjegjëse për rininë, si dhe.....

Fajtona Dhimitri - Cili është ky institucion përgjegjës?

Erzen Tola – Aktualisht është Shërbimi Kombëtar Rinor, i cili në bazë të këtij ligji...

Fajtona Dhimitri – Me anë të këtij projektligji Shërbimi Kombëtar Rinor...

Erzen Tola – Nuk ndryshon, është parashikuar përsëri që të ekzistojë si i tillë, mbase jo me atë emër, vetëm për shkak të ligjit nr. 90/2012.

Fajtona Dhimitri – Sipas projektligjit tuaj, i bie që Shërbimi Kombëtar Rinor të ketë dalë jashtë funksionit?

Erzen Tola – Ju lutem, më lini t’jua shpjegoj!

Aktualisht, sugjerohet nga Ministria e Drejtësisë që në ligje të mos shkruhen emra konkretë institucionesh varësie, sepse ligji nr. 90/2012 që është në fuqi, nuk e lejon këtë mënyrë shkrimi në draftet ligjore. Prandaj është shkruar institucioni përgjegjës për zbatimin e këtij ligji dhe i politikave rinore, i cili do të jetë në varësi të ministrisë, që do të organizohet dhe do të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Organet përgjegjëse do të jenë strukturat e përcaktuara në bashki dhe, për shkak të autonomisë vendore, përsëri në projektligj nuk mund të shkruajmë strukturat konkrete pranë bashkive se si mund të organizohen. Pra, por kjo mbetet në tagër të këshillave bashkiakë dhe kryetarëve të bashkive, sipas ligjit për vetëqeverisjen vendore, për të organizuar dhe për të miratuar strukturat për zbatimin e këtij ligji. Ne kemi parashikuar një detyrim ligjor, që pranë njësisë vendore, sipas kapacitetit së secilës njësi, të ketë struktura të posaçme për rininë.

Në kolonën e dytë janë Këshilli Kombëtar Rinor dhe Këshilli Vendor Rinor, të cilët janë organizata jofitimprurëse, të dy janë me statusin e organizatave jofitimprurëse, vetorganizohen dhe funksionojnë sipas kuadrit ligjor në fuqi, pra Kodit Civil, ligjit “Për organizatat jofitimprurëse” dhe këtij ligji.

Në kolonën e tretë janë të gjitha organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, të cilat përsëri janë të organizuara, sipas ligjit për organizatat jofitimprurëse dhe Kodit Civil. Pra, është një gamë e madhe strukturash, që janë të ndërthurura si horizontalisht, ashtu edhe vertikalisht për zbatimin e këtij ligji.

Në lidhje me organizatën ombrellë, ajo është marrë si një model nga vendet e rajonit, që kanë ligje për rininë dhe qëllimi i vetëm që është ngritur kjo organizatë, është përfaqësimi i të rinjve në nivel ndërkombëtar. Pra, në nivel ndërkombëtar, nuk mundet secila organizatë vendore rinore të bëjë përfaqësim ndërkombëtar, por, sipas kërkesave dhe rekomandimeve të Bashkimit Europian, duhet të ketë një organizatë ombrellë përfaqësuese e të gjitha strukturave rinore në Republikën e Shqipërisë.

Fajtona Dhimitri – Në lidhje me organizatat rinore, përcaktohet: “Organizata rinore janë persona juridikë jofitimprurës që krijohen, organizohen apo transformohen dhe funksionojnë në bazë të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë”. Në lidhje me rrjetet e tjera rinore, të cilat nuk janë të regjistruara apo funksionojnë si rrjete rinore, për shembull, këshillat

studentorë, pasi ky nen deri diku është diskriminues, ne i përjashtojmë nga fusha e veprimtarisë së këtij ligji?

Erzen Tola – Zonja kryetare, rrjeti rinor përbëhet nga të gjitha strukturat që përmendëm ne. Çdo organizatë jofitimprurëse, që ka për objekt të veprimtarisë së saj rininë apo të rinjtë, mund të përfshihet në këtë organizatë dhe në të gjitha strukturat e tjera të parashikuara nga ky ligj. Edhe këshillat studentorë, edhe qeveria e nxënësve, pra të gjitha strukturat që lidhen me veprimtarinë rinore dhe brenda moshës së përcaktuar nga ky ligj. Rrjeti rinor në vetvete është tërësia e të gjitha këtyre strukturave dhe organeve të parashikuara në ligj.

Në lidhje me infrastrukturën rinore, Ministria e Arsimit prej disa vjetësh, tashmë, ka edhe marrëveshje të nënshkruara me shumë bashki për qendrat rinore, për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e qendrave rinore, ka një inventar, ka një skanim në të gjitha njësitë vendore sa infrastruktura ka, por kjo nuk kufizohet vetëm në qendra rinore. Ne kemi bërë inventarin e strukturave në lidhje me stadiumet, shkollat, pra të të gjitha hapësirave, ku të rinjtë ushtrojnë veprimtari.

Fajtona Dhimitri – Pra, qysh në terminologjinë e tij, në draftimin e tij projektligji parashikon infrastrukturën rinore, por nuk parashikon shërbimet që përfitojnë këta të rinj; jep thjesht përcaktimin e hapësirës fizike.

Erzen Tola – Infrastruktura përbëhet nga të gjitha hapësirat, ku të rinjtë ushtrojnë veprimtari. Ne e kemi të skanuar, e kemi të inventarizuar dhe po mundohemi në të gjitha bashkitë të nxisim ngritjen e strukturave dhe hapësirave të tjera të sigurta për të rinjtë, sipas standardeve të secilës fushë ndërtimi. Në qoftë se bëhet fjalë për shkolla, ka standarde të veçanta; në qoftë se ka stadione, ka standarde të veçanta dhe kërkesa të veçanta; për institucionet e arsimit të lartë ka standarde të veçanta dhe për qendrat rinore ka standarde të veçanta, ku janë parashikuar edhe për të rinjtë me aftësi ndryshe të gjitha standardet që duhet të garantojnë dhe duhet të kenë hapësirat.

Zamira Gjini - Përshëndetje!

Në lidhje me 2-3 pyetjet që u bënë ishte një pyetje për buxhetin, për rininë. Ne kemi ligjin “Për buxhetin” dhe është detyrim ligjor i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë që është përgjegjëse për politikën rinore që sa herë harton projektbuxhetin, të konsultohet me shoqërinë civile, gjë që realizohet edhe sot, kur ende nuk kemi një ligj “Për rininë”.

Një pyetje tjetër ishte: a është në përputhje moshja e të rinjve me standardet e OKB-së? Nga Ministria e Arsimit dhe grupet e punës që kanë hartuar këtë ligj, nuk ka qenë e lehtë për të vendosur se cila do të jetë grupmosha e të rinjve dhe është dashur të shikohen modelet

e vendeve të rajonit apo të vendeve të Europës dhe të gjitha raportet e INSTAT-it. Në bashkëpunim me UNICEF-in është bërë edhe një pyetësor, i cili ka bërë pyetje *online* me të rinjtë. Nga të gjitha këto studime, nga përfundimet e pyetësorit është vendosur kjo grupmoshë e të rinjve. Grupet e punës, ekspertët ligjorë në hartimin e ligjit “Për rininë”, janë mbështetur nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, pra vetë organizata ka qenë pjesë në hartimin e këtij ligji dhe në të gjitha vendimet që janë marrë për përcaktimin, qoftë të grupmoshave apo edhe vendimmarrjeve të tjera për të hartuar aktet e këtij ligji.

Adelina Rista - Unë do të qëndroj te pyetja ime. Me sa kuptova nga përgjigjja që dhatë ju, bashkia miraton strukturën për funksionimin e saj në bazë të të gjitha drejtorive që ka në çdo fund viti për vitin pasardhës. Institucioni përgjegjës pranë ministrisë nuk ka një strukturë të gatshme, që ia dërgon çdo bashkie, por në bazë të kapaciteteve që ka vetë kjo e fundit, në bazë të numrit të të rinjve, apo organizatave që veprojnë përcakton në strukturën e saj pranë një drejtorie personat përgjegjës, që përgjigjen për...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, këtu thotë që ngrihet, por a ka një strukturë të gatshme që vjen nga ministria apo nga ne?

Fatjona Dhimitri – Neni 13, pika 3: “Ministria përgjegjëse për Rininë njihet vetëm një organizatë kombëtare përfaqësuese rinore pranë së cilës shtohen anëtarë të rinj në çdo kohë në përputhje me rregullat dhe statutin e miratuar”. Pra, i bie që ministria, sipas këtij projektligji njihet vetëm një organizatë kombëtare përfaqësuese rinore. Kjo organizatë duhet t’i shërbejë ministrisë, i bie që edhe vetë organizata duhet t’i shërbejë politikës. Pse njihet vetëm një organizatë përfaqësuese?

Besa Shahini - Organizata përfaqësuese është federalizimi, grupi i organizatave, minimalisht 30, mund të jenë më shumë, thjesht ata duhet të jenë anëtarë të rinj, minimalisht 1 mijë anëtarë mund të ketë organizata përfaqësuese rinore. Ideja është që organizatat individuale që mund të funksionojnë si të tilla dhe mund të aplikojnë me projektet e tyre për fonde, mund të vijojnë, por nëse duan t’i bashkojnë forcat dhe të organizohen bashkërisht për qëllime të përbashkëta, kanë edhe këtë mundësi. Por do të jetë një rrjet, një organizatë e madhe, që përfshin në vetvete bashkëpunimin mes organizatave...

Fatjona Dhimitri - Sipas projektligjit, përfaqësimi në organizatë duhet të jetë sipas numrit, ju e thatë deri në 1 mijë anëtarë apo edhe në bazë të veprimtarisë së tyre, të rezultateve konkrete të punës së tyre?

Besa Shahini - Organizatat rinore edhe ato për të rinjtë mund të bëhen pjesë e kësaj organizate të madhe përfaqësuese. Janë dy lloje të organizatave që i përshkruam edhe më parë: organizatat që në përbërjen e tyre kanë anëtarë të rinj dhe organizata që në veprimtarinë e tyre kanë në fokus të rinjtë dhe kanë bërë këtë veprimtari minimalisht 3 vjet apo edhe më shumë. Janë dy lloje organizatash që mund të bëhen pjesë e organizatës së madhe përfaqësuese për të rinjtë, por pjesa e cila është këshillëdhënëse për nismat e ministrisë apo edhe politikat rinore është tjetër, është Këshilli Kombëtar i Rinisë, i cili do të jetë gjithmonë i konsultuar për nismat, politikat dhe buxhetet e tjera. Organizata kryen një funksion tjetër nga ky.

Fatjona Dhimitri - Kalojmë në diskutimin në parim të projektligjit.

Po, zoti Beqiraj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi - Kolegë të dashur, nëse ju kujtohet ne dje ramë dakord për orarin e mbledhjes dhe mbledhja u detyrua të riorganizohej, ngaqë për këtë projektligj ka diskutime në disa komisione. Meqenëse prezantimin e projektligjit e bëri zonja ministre dhe pyetjet ia drejtuan zonjës ministre, morëm përgjigjet, a mund ta lëmë zonjën ministre të shkojë edhe në komisionet e tjera dhe ne të vazhdojmë me përfaqësuesit e ministrisë?

Fatjona Dhimitri - Mund të vazhdojmë.

Po, zoti Beqiraj

Ismet Beqiraj – Projektligji që po diskutojmë në parim, ka të bëjë me një shtresë të caktuar sociale të rëndësishme për shoqërinë, për të sotmen dhe të ardhmen, dhe përbën një risi në vetvete në të gjithë korpusin e ligjeve që miraton Kuvendi i Shqipërisë.

Ky projektligj, në radhë të pare, siguron bazën ligjore për një model të ri të përmirësimit të statusit shoqëror dhe të pozitës së të rinjve në vendin tonë. Nuk mund të themi se ka qenë në një boshllëk ligjor, sepse me vendimin e Këshillit të Ministrave të vitit 2014 ka qenë një institucion, Shërbimi Kombëtar për Rininë, pranë Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve. Por projektligji që po diskutojmë sot ka një aspekt më të gjerë, i cili mbron dhe promovon nevojat e kësaj shtrese të rëndësishme sociale në shumë fusha. E rëndësishme është që nëpërmjet këtij ligji jo vetëm hidhen bazat ligjore, por edhe krijohen mundësi për kushtet dhe adresimin e nevojave të rinisë në të gjitha fushat që përbëjnë interes rinor, ku me të drejtë do të veçoja disa prej tyre, edhe nëpërmjet pyetjeve që bënë kolegët. Për shembull, këtu definohet edukimi joformal për rininë, përveç formimit formal në të gjitha ciklet e arsimit. Edukimi joformal përbën një rëndësi të veçantë, në mënyrë që t'i përshtaten procesit të të nxënies dhe, nga ana tjetër, të fitojnë edhe kompetenca për të krijuar mundësi që ata të

vetëpunësohen apo të punësohen në tregun e punës. Është i rëndësishëm, si një risi e veçantë e këtij projektligji, edhe krijimi i hapësirave rinore të sigurta, që janë ato hapësira qytetare, të cilat kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e të rinjve në bashkëqeverisjen qendrore dhe vendore, në hapësirat publike që u japin mundësi të rinjve të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet sportive, kulturore, artistike, në hapësirat dixhitale për të komunikuar edhe në mënyrë virtuale me teknologjitë e sotme e me të rinjtë jo vetën në rrjetin kombëtar, por edhe në atë ndërkombëtar, nga ana tjetër, në hapësirat fizike për të mbështetur, për të promovuar një grup social vulnerabël dhe të marginalizuar të të rinjve.

Është e rëndësishme, ku me të drejtë u bënë edhe pyetjet e kolegëve për infrastrukturën rinore, që ky projektligj definon juridikisht përgjegjësinë e institucioneve qendrore dhe të vetëqeverisjes lokale për ringritjen e kësaj infrastrukture rinore.

Unë do të veçoja edhe pjesëmarrjen e të dyja organizatave, qoftë organizatat rinore dhe ato për të rinjtë, por më të rëndësishme janë edhe parimet bazë për mbështetjen e veprimtarisë së të rinjve.

Ky projektligj është shumë i qartë edhe në krijimin e institucionit përgjegjës për rininë, që do të bëhet me akte nënligjore, me vendim të Këshillit të Ministrave, ku në themel përbën edhe riorganizimin e Këshillit Kombëtar të Rinisë.

Gjatë diskutimit nen për nen, mund të bëjmë edhe korrigjime të veçanta, por jam dakord me këtë projektligj, që në këtë moment të caktuar i vjen këtij komisioni për diskutim, jo vetëm kaq, por është në përputhje të plotë edhe me programet që ka qeveria në fushën e mbështetjes rinore dhe meqenëse ky projektligj është i propozuar dhe vjen nga Ministria e Arsimit dhe është në vazhden edhe të një sërë ligjesh të tjera që plotësojnë korpusin e plotë të vëmendjes që ka kjo qeveri për brezin e ri, duke filluar që nga ligji “Për arsimin parauniversitar”, ligji “Për arsimin universitar”, ligji “Për kërkimin shkencor”, si dhe ligji “Për rininë”, i shtohet korpusit të ligjeve të rëndësishme për trajtimin, për mbështetjen dhe promovimin e brezit të ri në Shqipëri.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri - Ka diskutime të tjera?

Adelina Rista - Faktikisht është për t’u përshëndetur ardhja e një projektligji për rininë, si një grup me një status të caktuar shoqëror.

Duhet të falënderojmë ekipin e ministrisë për paraqitjen dinjitoze të këtij projektligji!

Ky projektligj ka të përcaktuar më së miri strukturën përgjegjëse për rininë, për t’i dhënë peshën dhe rëndësinë e duhur, institucionin përgjegjës në varësi të ministrit,

përgjegjësinë e njësive të qeverisjes vendore, që kanë tani peshën e përgjegjësisë ndaj këtij grupi të caktuar shoqëror. Ai përcakton më së miri fondet e dedikuara që u kalojnë bashkive, përveç të ardhurave që ato mund të krijojnë për të financuar veprimtaritë e të rinjve.

Qëllimi është jo vetëm promovimi i të rinjve, i vlerave të kësaj shtrese shoqërore, transmetimi i vlerave të tyre, por ajo që është më e rëndësishme, është rëndësia që ka ky grup shoqëror në vendimmarrje. Prandaj falënderoj sinqerisht ekipin e ministries, që paraqiti para nesh këtë projektligj!

Fatjona Dhimitri - Ka diskutime të tjera? Nuk ka.

Para se të kalojmë në miratimin në parim dua të them dy fjalë për projektligjin. Ashtu sikurse u shpreha edhe në fillim, projektligji ka qenë i vakët që në momentin e hartimit dhe të draftimit të tij. Mungesës së përcaktimit të objektit, të fushës së veprimtarisë, i shtohet edhe mungesa e një strukture zbatuese përgjegjëse për mbarëvajtjen e tij në nivel qendror dhe vendor. Edhe pse nga ekspertët e ministrisë u theksua se nuk do të përjashtohet Shërbimi Kombëtar i Rinisë, projektligji në përmbajtjen e tij e përjashton këtë të fundit, mohon edhe kompetencat e kësaj strukture. Karta rinore, siç e thamë, nuk është e parashikuar në projektligj. Projektligji nuk fokusohet aspak në praktikën e punës së të rinjve dhe në nxitjen e këtyre praktikave me ligj; nuk koordinon strukturat rinore lokale dhe kombëtare, si dhe punën e të rinjve në nivel lokal dhe kombëtar, duke mohuar edhe pikat e kontaktit, siç është koordinatori i rinisë. Ai nuk ka një strukturë vertikale dhe horizontale të organeve përgjegjëse të mirorganizuar për zbatimin e ligjit.

Projektligji nuk përfshin asnjë rregullim për të rinjtë pa shtetësi ose me shtetësi të huaj që jetojnë në Republikën e Shqipërisë. Ai nuk qartëson ndihmën që duhet të japë për të rinjtë shqiptarë, që jetojnë në diasporë dhe zhvillimin e tyre.

Po ashtu, në ligj nuk qartësohen aspak grupmoshat që duhet të konsiderohen si punonjës rinorë, duke krijuar kështu një pabarazi ndërmjet personave me më tepër eksperiencë si rrjedhojë e moshës dhe të atyre me më pak eksperiencë.

Nëse nuk ka të tjera diskutime, kalojmë në votimin në parim të projektligjit.

Kush është pro? Kundër? Unë dhe 2 vota të tjera kundër. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Milva Ekonomi – Kisha diçka për procedurë. Shumica e anëtarëve të komisionit janë dakord...

Fatjona Dhimitri – Unë thashë që ligji miratohet në parim.

Milva Ekonomi – 11 vota janë pro.

Fatjona Dhimitri – A ka ndonjë gjë tjetër për të shtuar?

Milva Ekonomi – Zonja kryetare a mund t’ju them diçka?

Në komision nuk mund të vendosni ju, sepse këtu vendoset sipas Rregullores, me votim dhe në votim ju duhet të përmendni si numrin e votave nga maxhoranca, ashtu edhe nga opozita. Nuk mund të thuash që vota ime është kundër, por duhet të thuash unë votoj kundër dhe nga opozita...

Fatjona Dhimitri – Unë thashë që vota ime është kundër dhe sekretariati më ndihmon lidhur me numrin e votave.

Milva Ekonomi – Më lini ta mbaroj fjalën, sepse ju kërkoja leje dhe askush nga anëtarët e komisionit nuk ka të drejtë të ma ndërpresë fjalën.

Ashtu siç ju kërkon t’i protokolloni gjërat në procesverbal, edhe maxhoranca kërkon t’i protokollojë...

Fatjona Dhimitri – Media është e pranishme, kemi sekretariat, kemi këshilltarin, të cilët numërojnë votat për miratimin e projektligjit...

Milva Ekonomi – Ju lutem, më lini ta mbaroj fjalën!

Media është e pranishme, sekretariati numëron votat, por fjalët procesverbalizohen, prandaj ju duhet ta përmendni këtë gjë. Mënyra se si ju e drejtoni mbledhjen, nuk është modeli i drejtimit të një komisioni. Në komision duhet të ketë barazi dhe këtë të drejtë ta jep Rregullorja, pavarësisht numrit të anëtarëve që janë të pranishëm në komision.

Ju lutem, bëni kujdes në momentin kur votohet!

Ju duhet të deklaroni se sa vota janë pro dhe sa janë kundër.

Fatjona Dhimitri – Projektligji u hodh në votim dhe u miratua.

Nëse nuk ka ndonjë gjë tjetër për të shtuar, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.07.2019, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

2. Miratimi i vendimit nr. 11 të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, për shpalljen e një vendi vakant pranë Autoritetit të Medieve Audiovizive, pas lirimit nga detyra të anëtarit të AMA-s, zotit Zylyftar Bregu, me vendimin e Kuvendit nr. 82/2019, mbështetur në pikën 2, të nenit 9, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Kostaq Papa dhe Selami Jenishehri.

Mungojnë:

Enada Kapllani, Klajdi Qama.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Milva Ekonomi – Kisha diçka për procedurë, sepse mbledhja duhet të vazhdojë. Ne mbaruam punë me Ministrinë e Arsimit, por kemi ende çështje të tjera që lidhen me komisionin, sidomos vendimi që kemi marrë dje në Kuvend.

Ne dje miratuam një vendim të Kuvendit për lirimin nga detyra të zotit Zylyftar Bregu, i cili ishte anëtar i AMA-s dhe komisioni sot duhet të shpallë vakancën.

Fatjona Dhimitri – Përpara se të mbyllim mbledhjen, përfaqësuesit e ministrisë duhet të jenë të pranishëm, nëse do të jetë e mundur, gjatë të gjitha seancave dëgjimore, si dhe gjatë procesit të diskutimit dhe të votimit nën për nën të projektligjit.

Ismet Beqiraj – Me propozim të vetë kryetares ne e kemi lënë që sot të përcaktojmë kalendarin e dëgjësive për projektligjin për Akademinë e Shkencave.

Milva Ekonomi – Kjo është diçka e rëndësishme, e cila duhet diskutuar patjetër, por ndërkohë ne duhet të presim një përgjigje në lidhje me shkresën e Kryeministrit nga Shërbimi Juridik i Kuvendit. Sapo të vijë përgjigjja kjo çështje duhet të vendoset në kalendarin e punës.

Zonja kryetare, unë mendoj që këtë çështje ta diskutojmë ditën e hënë.

Fatjona Dhimitri – Jam dakord me ju që çështjen e Akademisë së Shkencave ta diskutojmë ditën e hënë, menjëherë pas marrjes së përgjigjes nga shërbimet juridike.

Faleminderit!

Edhe pse kjo pikë nuk ishte parashikuar në rendin e ditës për sot, duke marrë parasysh zhvillimet që ndodhën dje gjatë seancës plenare, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në mbledhjen e datës 05.07.2019, pas lirimit nga detyra të anëtarit të AMA-s, zotit Zylyftar Bregu, me vendimin e Kuvendit nr. 82/2019, mbështetur në nenin 9, pika 2, e ligjit nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë” vendosi shpalljen e një vendi vakant për anëtar të Autoritetit të Medieve Audiovizive.

Ftoj të paraqesin kandidaturat e tyre për anëtar të Autoritetit të Mediave Audiovizive subjektet e mëposhtme: shoqatat dhe grupimet e medieve elektronike, shoqatat e medias së shkruar, profesoratin dhe Shoqatat e Inxhinierisë Elektrike dhe Elektronike, profesoratin e së Drejtës, të Gazetari - Komunikimit dhe Ekonomisë, shoqatat e juristëve, Dhomën Kombëtare të Avokatisë, organizatat jofitimprurëse që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, të drejtave të fëmijëve ose kërkimeve në politikat publike, ose përfaqësues të shoqatave që veprojnë në fushën e mbrojtjes së personave me aftësi të kufizuara.

Afati për paraqitjen e kandidaturave përfundon 30 ditë pas ditës së publikimit të këtij vendimi. Kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidaturat detajohen në njoftimin bashkëlidhur këtij vendimi, i cili është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim së bashku me njoftimin përkatës publikohen në faqen zyrtare të Kuvendit.

Hapim procedurën për plotësimin e vendit vakant.

A ka ndonjë gjë tjetër për mbledhjen e sotme? Nuk ka.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

MBYLLET MBLEDHJA